



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.09.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Elisa Spiropali – zëvendëskryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të datës 16.07.2018.
2. Miratimi i kalendarit të punës së komisionit për periudhën 3 - 21 shtator 2018.

Marrin pjesë:

Elisa Spiropali, Klodiana Spahiu, Ilir Pendavinji, Edlira Bode, Arben Kamami, Roland Xhelilaj, Almira Xhembulla, Vilma Bello, Blerina Gjylameti dhe Nuri Belba.

Mungojnë:

Petrit Vasili, Vangjel Tavo, Adelina Rista, Grida Shqina, Flamur Golemi, Floida Kërpaçi, Bardh Spahia, Halim Kosova, Orjola Pampuri dhe Lindita Metaliaj.

HAPET MBLEDHJA

Elisa Spiropali - Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Shëndetësisë me miratimin e kalendarit të punës së komisionit për periudhën 3 - 21 shtator 2018.

Nëse do të biem dakord, në datën 13, ditën e enjte, në orën 09:30, para fillimit të seancës, do të shqyrtojmë projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së zbatimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), për projektin “Këshillimi për migracionin në Shqipëri”.

Potencialisht në datën 19 të këtij muaji do të zhvillojmë një seancë dëgjimore në lidhje me progresin e skemës së modernizimit të ndihmës ekonomike dhe asistencës sociale, kërkesë kjo e bërë nga ne dhe nga përfaqësuesit e opozitës.

A jeni dakord që në datën 13, ora 09:30, të shqyrtojmë projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së zbatimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe Agjencisë Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ), për projektin “Këshillimi për migracionin në Shqipëri” dhe në datën 19, ora 10:00, të bëjmë seancën dëgjimore për modernizimin e skemës ekonomike?

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet me 10 vota.

Faleminderit!

Falënderoj edhe dy kolegët nga Komisioni i Ekonomisë që ishin prezent.

MBYLLET MBLEDHJA